

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu, ne qeshtjen juridike te paditesest ; I mituri nga te cilin e perfaqson perfaqsesja ligjore e ema nga Rr, nr. , kunder te paditurit; nga Rr. baza e kontestit; Alimentacion, vlera 50,00 Euro, me dt.14.03.2013, bie kete

A K T G J Y K I M

– **REFUZOHET** kerkespadia e paditesit- te mitur te cilin e perfaqson perfaqsesja ligjore e ema nga me te cilin kerkoj qe kjo gjykat ta obligoi te paditurin i nga Komuna e qe ne emer te alimentacionit ti paguaj shumen prej 50,00 Euro ne Muaj dhe ate prej 1-5 te muajt vijues, duke filluar nga dita e paraqitjes se padise e gjersa te egzistojn kushtete ligjore per kete, **ne tersi si e pabazuar.**


Secila pale i bart shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesja ne padin dhe kerkespadin e saje te parashtruar si dhe ne seancat e mbajtura ka theksuar se ; me te paditurin kane jetuar ne bashkesi jashtmartesore. Mirepo per shkak te mosmarrveshjeve te perhershme kete bashkesi jashtmartesore e kane shkeputur. Gjate kesaje kohe iu ka lindre femija i perbashket jashtmartesor i lindur me 27.09.2002.

Paditesja ka mbetur pa mjete themelore per egzistenc per ushqimin dhe rritjen e ketije femiu. I padituri nuk punon dhe nuk ka te mira material.

Ne seance e shqyrtimit deklaroi se i gjendet ne kujdesje te une qe nga ndarja. Nuk eshte ne marrdhenje pune dhe nuk realizon kurfar fitimi, jeton te prinderit e saje . I padituri nuk eshte ne marrdhenje pune e as prinderit e tije, thjeshte kane nje baze te dobet materiale, mirepo femiu duhet te kete nje zgjidhje materiale.



Ne fjalen perfundimtare i propozon gjykates qe kerkespadin ta aprovoi si te bazuar.

Gjykata séance e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te paditurit te ftuar me rregullkonform nen 423.2 te LPK.

I padituri ne séance pregaditore deklaroi; e kontestoi kerkespadin duke theksuar se me vullnetin me te mire i kisha ndihmuar mirepo per kete nuk kame mundesi, sepse nuk jame ne marrdhenje pune, nuk realizoi kurfar fitimi, jetoj te prinderit e mi e qe te gjithë antaret e familjes jetojm me nje pension te babait dhe thjesht jemi ne gjendje te veshtire ekonomike. Nuk posedojm kurfar pasurie as te lujtshme e as te palujtshme.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim ten en. 8.1 te LPK,erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.


Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi keto prova; lexoi Qertifikaten mbi gjendjen e konomike te perfaqseses ligjore te paditesit te mitur te dt. 20.02.2013, te lshuar nga Komuna e , Qertifikaten mbi gjendjen ekonomike te paditurit Nr. dt. 08.02.2013, te lshuar nga Komuna e s, Vertetimin nga QPS-ne nr. lt. 12.10.2012 dhe konstatoi kete gjendje faktike;

Nga Qertifikata mbi gjendjen ekonomike ne emer te perfaqsesit ligjore te paditesit te mitur e sipercekur, konstatohet se nuk realizon kurfar burimi te te ardhurave.

Nga Qertifikata mbi gjendjen ekonomike e sipercekur ne emer te paditurit, konstatohet se i padituri eshte i papune, nuk realizon kurfar burimi te ardhurave dhe se jeton ne bashksi familjare 7- antar te familjes.

Nga vertetimi I QPS- ne i sipercekur, konstatohet se eshte aplikuese per asistence sociale prane kesaje Qendre.

Gjykata ne nje gjendje te ketille faktike kishte parasysh detyrimet e prinderve qe te iu ofrojne mbajteje financiare per femiun e tyre, konform nen. 290 te Ligjit per familjen i Kosoves dhe ne menyre te pershtatshme hetoi te gjitha rrethanat qe jane me rendesi per te vendosur lidhur me kete qeshtje lendore dhe erdhi ne furfundim dhe konstatoi se ; paditesi i mitur ka nevojë qe ti ndihmohet materialisht ne kete drejtim, Mirepo gjykata nuk ka asnje prove apo informate se i padituri , realizon qfardo burimi te te ardhurave, qka nje fakt te ketille pohoi edhe vet perfaqsesja ligjore e te miturit e cila theksoi se i padituri nuk eshte ne marrdhenje pune, nuk realizon kurfar te hyrash materiale dhe thjeshte ka nje gjendje te veshtir ekonomike. Prandaje ne nje gjendje te ketille gjykata vendosi si ne dispozitive ne menyre qe paditesi i mitur te munde te realizoje mbeshtetje Institucionale ne aspektin material, sepse konsideron se kete e



3.

kerkojne rrethanat konkrete nga se i padituri nuk ka mundesi reale qe te kontriboje materialisht ne kete drejtim.

vf

Vendimi mbi shpenzimet procedurale ,bazohet ne dispoziten e nen. 347 te njejt ligj

Nga te cekurat u vendos si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVUCE,
C. nr. 255/2012 dt 14.03.2013.



KESHILLE JURIDIKE-Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrihet ankese ne afat preje 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine e permes kesaje gjykate.